Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 060/01-44262 dt. 20/10/ 2026

Në bazë të nenit 40,43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gllogocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit

Th ë rr e t

mbledhjen e **rregullt** të Kuvendit Komunal, e cila do të mbahet më **dt: 29.10.2026** e cila do të fillojë në orën **10:00.**
Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit.
Për shqyrtim në mbledhje propozohet ky rend i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal i mbajtur me dt: 25.09.2026 dhe procesverbali i mbledhjes se jashtëzakonshme i datës 09.09.2026;
2. Deklaratë mbështetëse për parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike;
3. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Gllogocit;
4. Propozim vendim për miratimin e Raportit mbi punën dhe aktivitetin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Drenasit Nr.02-052/01-43152 të datës 12.10.2026;
5. Propozim vendim për diskutim të Raportit të auditimit të pajtueshmërisë "menaxhimi i pronave të dhëna me qira në Komunën e Gllogocit për periudhën 2024-2025;
6. Propozim vendim për themelimin e organit të kujdestarisë në kuadër të Qendrës për punë sociale;
7. Propozim Vendim për shpalljen e Interesit të përgjithshëm Publik të parcelës nr.391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për punë sociale –Drenas
8. Raporti Financiar Janar-Shtator 2026;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Burim Bajupi

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr.-060b4-44261 dt. 20/10/2026

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, mbajtur më 25.09.2026. Mbledhja filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi **Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi,** i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt. Në sallë ishin të pranishëm 27 anëtarë.

Të pranishëm në mbledhje ishin: Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi. Anëtarët e Kuvendit: Ekrem Elshani (PDK), Naim Gjeli (PDK), Anjeza Kurtaj (PDK), Selman Qallapeku (PDK), Valdet Curri (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Erblinë Morina (PDK), Fitore Morina-Hoxha (PDK), Edon Nishori (PDK), Qëndresë Xhema (PDK), Driton Ajazi (PDK) Mërgim Pirraku (PDK), Arigon Sinani (PDK), Jahir Hajdari (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Muhamet Xhemajlaj (PDK), Artian Krasniqi (PDK), Pajtime Berisha (PDK), Luljeta Elshani (PDK), Tringa Bujupi (PDK), Egzona Tërdevci (VV), Xhavit Drenori (GREEN), Arbër Halilaj (BD), Mehedin Salihu (Për Drenas e për Kosovë), Egzon Qorri (LDK), Liman Krasniqi (NISMA).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, stafi i Zyrës së Kryetarit drejtorët e drejtorive komunale dhe përfaqësuesi i KLGI-së, Kushtrim Kaloshi, të cilit kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, ia dha fjalën të flasë për t'i informuar asamblistët rreth vlerësimit të performancës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kushtrim Kaloshi, përfaqësuesi i Institutit Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), fillimisht i përshëndeti të pranishmit e më pas bëri paraqitjen e programit për monitorimin e anëtarëve të kuvendeve komunale në të gjitha komunat e Kosovës. Ky projekt ka filluar në korrik dhe do të përfundojë në mars, ai financohet nga Bashkimi Evropian, Ambasada e Suedisë dhe e Zvicrës, dhe zbatohet në bashkëpunim me katër organizata. KLGI, ATRC, SBM.
Qëllimi i këtij monitorimi është të monitorojë dhe të vlerësojë në mënyrë objektive punën e secilit anëtar të kuvendeve komunale në të gjitha komunat e Kosovës, si dhe t'i nxjerrë në pah anëtarët më aktivë të kuvendeve komunale.
Vlerësimi do të bëhet në tri role.
1. Si përfaqësues i qytetarëve, që nënkupton sa takime me qytetarë mban me këshilla lokale,

shoqëri civile, veçanërisht me gratë dhe grupet e margjinalizuara.
2. Roli juaj në hartimin e akteve komunale, që nënkupton kontributet me propozime gjatë periudhës së shqyrtimit të akteve komunale, nismave për rregullore të reja dhe çështjeve të tjera buxhetore.
3. Si mbikëqyrës të ekzekutivit, që nënkupton kërkesat tuaja për llogaridhënie, raporte, komente dhe mbikëqyrje të punimeve në terren.
Vlerësimi do të bëhet mbi bazën e dëshmive të verifikueshme. Procesverbaleve, incizimeve, dokumenteve zyrtare, listave të pjesëmarrjes, fotografive dhe iniciativave me shkrim. Po ashtu, do të monitorohen rrjetet tuaja sociale, se sa jeni aktivë në paraqitjen e punës suaj. Në fund të procesit, në prill, planifikojmë të bëjmë një aktivitet qendror ku do të shpërblehen tri angazhimet më të suksesshme, anëtari më aktiv i të gjitha kuvendeve komunale, anëtarja më aktive e të gjitha kuvendeve komunale dhe anëtari më aktiv në Kuvend. Janë këto tri role që do të vlerësohen, por ju informoj se shefat e grupeve kuvendare dhe kryesuesi i Kuvendit nuk hyjnë në garë. Nuk është hera e parë, ka pasur përvoja edhe më parë, ne kemi marrë përvoja nga organizatat e mëparshme që e kanë zbatuar, e kemi përmirësuar qasjen dhe do të theksojmë të jemi transparentë dhe të paanshëm.
Mbledhja do të ketë këtë:

REND TË DITËS

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal të mbajtur me 31.08.2026;
2. Propozim-Buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029;
3. Propozim-vendim për plotësimin dhe ndryshimin e pikës 1 të vendimit 02 nr.020/04-11325 të datës 30.03.2026 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL "Eko-Drenasi" Sh.a;
4. Propozim-vendim për vazhdimin e zbatimit të rendit ekzistues të udhëtimit për operatorët e transportit publik të udhëtarëve me autobus në Komunën e Drenasit, për linjat urbano-periferike;
5. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelës nr.391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për punë sociale – Drenas;
6. Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2025;
7. Raporti i të dhëna
8. ve për përformancën komunale për vitin 2025;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi theksoi se, para se të kalonte në hapjen për debat të rendit të ditës, i pranishëm në sallë ishte edhe z. Osmani për pikën numëre pesë. Ai u shpreh.Për këtë pikë e kemi lejuar të jetë prezent në mbledhjen e kaluar. Sipas informacioneve që kam, z. Osmani i ka takuar të gjithë asamblistët për pikën e pestë, për çështjen e pronës së tij, mirëpo një pjesë e asamblistëve janë ankuar se për shkak të presionit nuk munden me votu në praninë e z. Osmanit. Kështu që, me mirëkuptim, kërkoj që ta lironi sallën dhe të vazhdojmë me

procedurat e tjera. Siç e dini të gjitha, mbledhjet janë online përmes web-faqes tonë zyrtare dhe kanalit YouTube, kështu që mundeni me përcjellë dhe me e pa edhe votimin.

Egzona Tërdevci theksoi se, seanca është e hapur dhe kushdo që ka interes me ndëgju seancën ka të drejtë me qenë këtu. Për me bërë seancën e mbyllur, paraprakisht është dashur të ketë një votim dhe kjo është shkelje procedurale, por besoj që MAPL-ja mundet me na dhënë mendimin e vet për këtë shkelje. Sa i përket rendit të ditës, së pari ju falënderoj për mirëkuptimin që e keni treguar në seancën e kaluar duke e shtyrë këtë pikë, por prapë kërkoj mirëkuptimin tuaj. Sipas informacioneve që i kemi, është thirrur një seancë gjyqësore për këtë çështje me 6 tetor, prandaj unë propozoj që kjo pikë të shtyhet deri pas vendimit të seancës, kur seanca të japë një vendim, atëherë do ta trajtojmë si pikë në Kuvendin Komunal.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, a mundesh me shpjeguar për çfarë është thirrur seanca gjyqësore, cilat janë kërkesat e palës, cilat janë arsyetimet, me cilin ligj. Edhe pastaj flasim. Seancat gjyqësore asnjë veprim tonin nuk e ndalojnë me e pasë në rend të ditës dhe me votuar për ose kundër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi tha se, e ka në procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Para fillimit të mbledhjes, u dakorduam bashkërisht me shefat e grupeve punuese që pika në fjalë e rendit të ditës të diskutohet, por të mos votohet, me arsyetimin që të kemi material shtesë në mbledhjen e ardhshme. I kemi marrë të gjitha materialet dhe secili e ka mendimin e vet të votimit, kështu që nuk e shoh asnjë arsye për me e shtyrë.

Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci tha se, ju e keni para vete një propozim-vendim për miratimin e një deklarate për mospajtimin e Komunës së Drenasit ndaj vendimit gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës, shpallur më 16 shtator 2026. Në arsyetim e keni pasur një gabim teknik të cilin e kemi përmirësuar, prandaj kërkoj të hyjë në rend të ditës.

Valdet Curri, tha se edhe ai e ka një kërkesë për një pikë të rendit të ditës. Propozim-vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Erblinë Morina, tha se e ka një kërkesë për një pikë shtesë të rendit të ditës. Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Ankesave, i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Driton Ajazi tha se, në seancën e kaluar, të gjithë një zëri kërkuam që të na jepet kohë për pikën e pestë. Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas.
Në mënyrë që të dy palët të na sigurojnë dokumentacion të mjaftueshëm, që ne si përfaqësues të qytetarëve të mos vendosim diçka që mund të dëmtojë qoftë njërën apo tjetrën palë, në të njëjtën kohë i kemi pranuar edhe disa dokumente nga pala pretenduese. Si rezultat i kësaj është edhe një kërkesë për seancë gjyqësore që pritet të mbahet më 6 tetor. Duke parë ndjeshmërinë e kësaj pike dhe duke mos dashur që ne ta luajmë rolin e gjykatës për të vendosur për asnjërën palë në këtë

rast, kisha propozuar të shtyhet edhe për një muaj, ndërsa nëse në seancën e ardhshme nuk arrin t'i jepet epilog, ne do të vazhdojmë tutje me pikën në fjalë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, nuk ka pasur dy palë këtu për të sjellë pro dhe kundër dokumente, sepse një dokument i komunës që e ka vulën më shumë se 40 vjet që është pronë e tij, asnjëherë nuk kemi thënë që nuk ka qenë pronë e tij dikur. Sot, pas 40 vitesh, është pronë e Komunës dhe nuk ka ligj që e thotë ndryshe. Kjo temë, për të votuar për ose kundër, është në rendin e ditës, keni kohë për të debatuar. Seancat për t'i dhënë masë të përkohshme gjykatës i ka paraqitur pala tjetër, i kemi paraqitur ne. Nuk i ka paraqitur me masë të përkohshme të shpejtë, sepse e di që nuk mundet me fitu. Unë ju kërkoj pikën pesë me e debatu, me u diskutu dhe me e votu për ose kundër, si të shihni të arsyeshme, sepse nuk kemi kohë, duhet me vazhdu me procedurat tjera.

Ekrem Elshani, tha se e ka një pikë shtesë të rendit të ditës. Raporti i të dhënave për performancën komunale për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, ashtu siç kërkuan edhe këshilltarët komunalë që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë, si dhe propozim-vendimi i deklaratës së kryetarit, po ashtu e ceku se kërkesa e znj. Tërdevci dhe z. Drenorit është që në qoftë se kalon ky rend i ditës, miratimi i deklaratës të jetë si pikë e parë e rendit të ditës.
Me këto propozime, e hodhi në votim këtë:

RËND TË DITËS

1. Propozim-vendim për miratimin e Deklaratës së mospajtimit të Komunës së Drenasit ndaj vendimit gjyqësor të Dhomave të Specializuara të Kosovës të shpallur më 16 shtator 2026;
2. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur më 31.08.2026;
3.Propozim-buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028–2029;
4.Propozim-vendim për plotësim-ndryshimin e pikës 1 të vendimit 02 Nr. 020/04-11325 të datës 30.03.2026 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL "Eko-Drenasi" Sh.a;
5.Propozim-vendim për vazhdimin e zbatimit të rendit ekzistues të udhëtimit për operatorët e transportit publik të udhëtarëve me autobus në Komunën e Drenasit, për linjat urbano-periferike;
6.Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesë e parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas;
7.Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2025;
8. Raporti i të dhënave për performancën komunale për vitin 2025;
9.Propozim-vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;
10. Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Ankesave, i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
11.Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

Pas propozimeve për pikat e shtuara, **kryesuesi i Kuvendit Burim Bujupi** e hodhi rendin e ditës në votim. Për votuan 25, kundër 0, abstenim 1.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, pasi përshëndeti të pranishmit, e lexoi deklaratën. Bazuar në nenin 11, 12, 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 34 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës), Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.09.2026, miratoi këtë.
Propozim-Vendim Për Miratimin e Deklaratës së mospajtimit të Komunës së Drenasit ndaj vendimit gjyqësor të Dhomave të Specializuara të Kosovës të shpallur më 16 shtator 2026.
Lidhur me publikimin e Aktgjykimit të shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në çështjen e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur më 25.09.2026, duke respektuar pavarësinë e sistemit gjyqësor, parimet e drejtësisë penale, duke shprehur dinjitet dhe respekt të veçantë për viktimat, miraton këtë Deklaratë.
1. Kuvendi shpreh mospajtimin e thellë me Aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të shpallur më 16 shtator 2026, ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, e konsideron atë të padrejtë, të pabazuar, dhe si i tillë anashkalon kontekstin historik të ngjarjeve jetike për Kosovën dhe qytetarët e saj.
2. Qëndrimi i Kuvendit mbështetet në parimin se çdo vendim i gjyqit duhet të jetë i mbështetur në fakte, prova dhe ligj, në një proces të drejtë gjyqësor në të cilin duhet të vlerësohen provat e pakontestueshme, bindëse dhe të besueshme. Përgjegjësia e individëve nuk duhet interpretuar si fajësim kolektiv për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe luftën e drejtë të popullit të Kosovës për çlirim, të mbështetur nga bota demokratike. Për Drenasin, si pjesë e trevës së Drenicës, ruajtja e këtij dallimi ka rëndësi të veçantë.
3. Kuvendi njeh vuajtjet e viktimave civile dhe familjeve të tyre, si dhe të drejtën e tyre për dinjitet dhe drejtësi. Mospajtimi me aktgjykimin nuk e mohon nevojën që krimet e provuara me fakte të trajtohen me objektivitet.
4. Në aktgjykimin e shkallës së parë, dënimet nga 13 deri në 25 vjet burgim, Kuvendi i vlerëson të padrejta dhe vlerëson se ky vendim duhet të shqyrtohet dhe të korrigjohet përmes mjeteve juridike që ligji ua njeh palëve. Çdo shqyrtim duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe ekskluzivisht mbi faktet e pakontestueshme.
5. Kuvendi shpreh solidaritet me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit, Pjetër Shalës dhe Salih Mustafës, njëkohësisht u bën thirrje qytetarëve të Drenasit që qëndrimet e tyre t'i shprehin me qetësi dhe në mënyrë paqësore e institucionale.
6. Kuvendi inkurajon institucionet e nivelit qendror për unitet në trajtimin e kësaj çështjeje dhe kërkon koordinim të veprimeve ndërinstitucionale në drejtim të konstatimit të së vërtetës dhe ky proces të trajtohet si interes jetik për vendin. JO NË EMRIN TIM!

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, meqë nuk ka diskutime, atëherë e hodhi në votim. **Propozim-Vendimin Për Miratimin e Deklaratës së mospajtimit të Komunës së Drenasit ndaj vendimit gjyqësor të Dhomave të Specializuara të Kosovës të shpallur më 16 shtator 2026, lidhur me publikimin e Aktgjykimit të shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, në çështjen e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.**
Për votuan 26, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e dytë. **Pika (2) Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal mbajtur me 31.08.2026.**
Diskutime nuk pati dhe e hodhi në votim pikën e dytë .
Për votuan 26, kundër 0, absetim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e tretë. **Pika (3) Propozim-Buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029.**

Egzona Tërdevci tha se, të arsimi fillor planifikimi i subvencioneve është paraparë 158 mijë e 65 euro, nëse mundem me ditë pse janë paraparë, gjithashtu edhe një problematikë që përsëritet që pesë vite, votoj për buxhetin, por gjithmonë është e njëjta çështje, është kategorizim i disa projekteve në një kod të vetëm dhe ne si asamblistë nuk e kemi asnjëherë të qartë për çka po votojmë. Drejtori i ri është i ri në punë, por drejtori i kaluar na ka premtuar se do të na sjellë një shpjegim më të hollësishëm se cilat janë projektet që po votohen. Unë mendoj se ky buxhet nuk i paraqet as së afërmi nevojat e qytetarëve të Drenasit, janë projekte që ripërsëriten në buxhet, por nuk realizohen.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se sa i përket pjesës për subvencionimin e arsimit fillor do ta sqarojë drejtori i financave: është për pagesat e transportit për nxënësit, ata që janë mbi 4 kilometra, por edhe personat që janë në rrezik të madh nga trafiku, siç është rruga me katër korsi. Sa i përket kodit, disa herë e kemi sqaruar se nuk mund të caktojmë kode për çdo rrugicë, për këtë arsye i kemi futur dy-tri fshatra në një kod. Sa i përket buxhetit që nuk i plotëson nevojat, është e saktë, sepse komuna jonë është diskriminuar nga niveli qendror me buxhet dhe të gjitha projektet që kanë filluar në komunën tonë nuk janë duke u zhvilluar, i kanë ndaluar. Me pas qenë unë pjesë e qeverisë, si ju kisha sjellë investime të mëdha në këtë zonë.

Egzona Tërdevci, deklaroi Po thua që na kanë ndalur buxhetin, por asnjëherë nuk ka pasur më shumë financim nga granti qendror sesa tani – i ke 22 milionë për vitin 2026. Ndërkohë, projektet nuk janë ndalur; mos i keqinformo qytetarët, pasi bëhet fjalë vetëm për pengesa procedurale që janë duke u zgjidhur. Nuk është se nuk ka investime; tani e keni promovuar çerdhen në Arllat, kurse dy të tjera janë të planifikuara në Nekoc dhe Tërstenik. Duhet bashkëpunim nga komuna për t'i tërhequr [thithur] investimet.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, kur i drejtoheni qytetarëve me 22 milionë, trego çka përfshijnë, po flet për grantin e pagave e mëditjeve që është detyrim ligjor, ne folëm për investime, se ti pyete; buxhetin e kemi shfrytëzuar në mënyrën më të mirë të mundshme, sepse që 11 vite nuk e kemi asnjë akuzë të vetme nga organi drejtues.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, tha se para nesh e kemi propozim-buxhetin e Komunës së Drenasit, fillimisht shprehi mirënjohjen time për të gjithë ata që kanë kontribuar për përgatitjen e këtij dokumenti, kontribut ka dhënë asambleja dhe KPF-ja, kemi pasur edhe dëgjim buxhetor, gjithashtu bashkë me ekzekutivin dhe anëtarët e kuvendit kemi pasur një punëtori tre-ditore, kështu që së bashku mund të nxjerrim më të mirën.

Driton Ajazi tha se, deklarata e znj. Tërdevci se qeveria i ka dhënë 22 milionë grant qeveritar më bëri me reaguar, kjo iu drejtua qytetarëve që nuk janë ekonomistë e nuk e kuptojnë aspektin legjislativ edhe ekonomik. Qytetarë të dashur, qeveria këto 22 milionë është e obliguar në bazë të legjislacionit në fuqi për kokë banori t'i shpërndajë secilës komunë, sepse po t'i kishte dhënë 22 milionë investime kapitale, i kishim duartrokitur të gjithë. Me të vërtetë është për të ardhur keq, sepse Drenasi ka mbetur si vrimë e zezë në mungesë të investimeve kapitale prej nivelit qendror, duke filluar prej rrugës Komoran-Drenas-Skenderaj, shtëpisë së shëndetit që vetëm e kanë hapur një gropë e cila u mbush me ujë që dy vite e vetëm rrezikohen njerëzit edhe kafshët, pastaj mungesa e një nënkalimi të shkolla në Zabel të Ulët ku ka pasur aksident me fatalitet aty, rastin e njëjtë e kemi edhe në rrugën për Malishevë që është në nivel regjional në fshatin Arllat, pastaj çështja e ujit që është jetike për qytetarët e Komunës së Drenasit, ku është bërë fizibiliteti i projektit për liqenin e Verbocit, por niveli qendror është ai që e ka penguar një projekt të tillë, arsyeja është puro politike, sepse slogani "cep më cep" po arrijnë me e zhvilluar në Komunën e Drenasit. Por uroj në të ardhmen të reflektojnë, sepse edhe ne jemi qytetarë të Republikës së Kosovës dhe është vendi që ka kontribuar më së shumti për lirinë e këtij vendi.

Egzona Tërdevci, iu drejtua Dritonit. Je asamblist për herë të parë dhe e kuptoj që nuk e dinë qysh funksionon asambleja, sepse dole komplet jashtë temës, po ti vetëm për buxhet të nivelit lokal nuk fole, je ekonomist, nuk e di sa e zotëron punën tënde. Granti qendror të gjithë e dimë si ndahet, por kurrë nuk ka qenë 22 milionë, sepse nuk ka qenë buxheti i rritur si është në qeverisjen e Lëvizjes Vetëvendosje. Fole për projektin e rrugës, unë jam duke punuar aty që 6 muaj, nuk e di që ka projekt, por nëse mundesh me ma gjetur ti, e kisha prit me shumë entuziazëm. Fole edhe për disa projekte tjera që niveli qendror i ka filluar e nuk po i zbaton, ti nuk i dinë problemet që janë shkaktuar prej komunës, por bisedo me kryetarin dhe të tregon qysh e ka bërë keq projektin për QKMF-në dhe të tregon pse ka mbetur projekti mbrapa. Unë nuk besoj që diskutimi për buxhet duhet me qenë mes neve asamblistëve, sepse ne duhet me kërkuar prej drejtorive me shtu buxhetin e prej kryetarit me i zbatu projektet që i ka, e jo me debatu ne mes veti.

Driton Ajazi tha se, unë këtu jam si përfaqësues i zgjedhur i qytetarëve të Drenasit dhe nuk jam zëdhënës i askujt, jam këtu me ju treguar qytetarëve mos me i qitë në lajthitje si ti. Si anëtare e kabinetit të ministrit, pse nuk po lobon me sjellë 20 milionë investime kapitale në Komunën e Drenasit.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, po të lutem publikisht, mos provo me mashtru qytetarin për projektin e QKMF-së në Drenas.Unë e falënderoj z. Qorri që e ka bërë projektin falas. Këtë projekt e ka marrë Ministria e Shëndetësisë, e ka parë e analizuar me ekspertët e USAID-it për tri vjet dhe e ka dhënë miratimin.Dikush që e merr një tender, para se me nënshkruar kontratën, duhet me kontrolluar pikë për pikë nëse përputhen të gjitha pozicionet që i takon t'i kryejë operatori ekonomik. Për dijeninë tende, operatori ekonomik ka marrë avans (paradhënie) për atë projekt, ka filluar e ka hapur gropën dhe pastaj ka bërë konflikt interesi, ku na ka dërguar e-mail zyrtare dhe ka kërkuar me e reviduar (rishikuar) objektin — domethënë, nga pesë metra lartësi të murit me zbritë në tri metra, dhe duke e zbritur lartësinë, me zbritë edhe vlerën në ndriçim, në ftohje e në ngrohje, për me mundur me pasë fitim më të madh, se ka menduar që po ndërton ndërtesa banimi, e jo spital.I njëjti projekt nga i njëjti autor i projektit

është në procc të përfundimit në Istog. Po si me thënë që projekti u bë keq, sepse ekspertët e USAID-it e kanë pranuar.

Egzona Tërdevci tha se, nuk po provoj me i qitë në lajthitje, kjo është përgjigjja e Ministrisë së Shëndetësisë se problemi është tek projekti, por megjithatë po pajtohem në një çështje me ty, që kjo punë ka me marrë epilog qoftë me gjykatë, qoftë me formën që keni me zgjedhur në bashkëpunim të dy palët, por e vërteta ka me dalë në pah. Por është keq që si shkak i gjithë këtyre problemeve, qytetarët janë duke u vonuar me i marrë shërbimet prej QKMF-së së re dhe secili ndihemi keq që është duke u vonuar ky projekt.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha epilog ka për të marrë, por nuk është mirë që të mbetet gropa e hapur për dy vite para QKMF-së. E para është kjo. E dyta, më ke lënë pa e miratuar buxhetin për urën e Shtrubullovës, pasi unë jam pajtuar me një SMS të ministrit para zgjedhjeve. E treta, në këtë kuvend e kam pasur buxhetin e miratuar për Grykën e Gashit në Nekoc dhe ajo ende nuk është bërë. E katërta, qeveria e ka nisur projektin 'Drenasi II' të Parkut të Biznesit, nëse ne e paskemi bërë keq projektin e QKMF-së, po projektin 'Drenasi II' kush e ka bërë keq, Egzonë. Sa i përket rrugës me katër korsi, nuk e kam unë obligim ta bëj projektin e nivelit qendror. Unë e kam obligim t'ia tregoj qeverisë kufijtë e rrugës, në mënyrë që ajo të bëjë plan se çfarë buxheti do të na ndajë nëse hyjmë në prona publike të dikujt. Ndërsa rruga me katër korsi deri në kufi me Skenderajn është e shpronësuar, nga 26 deri në 28 metra. Pra, është i vetmi projekt në Kosovë që mund të zhvillohet pa gjakderdhje financiare.

Driton Ajazi theksoi se, kolegia jonë, Egzona, e vuri në pikëpyetje aspektin tim profesional, si dhe mungesën e argumenteve gjatë diskutimit. Unë asnjëherë nuk flas **kuturu (pa plan dhe pa baza)** dhe nuk mashtroj në asnjë mënyrë. Në esencë të mashtrimit është partia që përfaqësoni ju, sepse që nga ardhja në pushtet, çdo gjë ka qenë mashtrim. Që kur jam në politikë, unë argatin ua kam bërë vetëm qytetarëve – me argumente dhe jo me fjalë boshe. Ndërsa ju i keni marrë votat nga qytetarët e Komunës së Drenasit dhe luani rolin e zëdhënëses së qeverisë. Madje, keni lobuar që të dështojë seanca e jashtëzakonshme për ujin e pijshëm, sepse ajo ndërmarrje është kapur nga qeverisja qendrore dhe militantët e Vetëvendosjes. Ata, po të mundnin, do të na ndalnin edhe ajrin, e jo më ujin e pijshëm.

Egzona Tërdevci theksoi se, mua po më vjen keq për nivelin e diskutimit nga kolegu. Deri diku e kuptoj, sepse është pak e rëndë për të që të shohë që unë e kam mandatin e dytë dhe qëndroj parimore. Mua më kanë votuar qytetarët e Drenasit për asambliste dhe e mbroj me dinjitet secilin interes të tyre. Për ty është pak e vështirë të shohësh që dikush qëndron drejt, ndërsa ti je thyer e je nënshtruar ndaj kundër kandidatit tënd. Rruga Skenderaj-Komoran ka për t'u bërë në qeverisjen tonë, kurse për urën, memorandumi është nënshkruar para dy muajve, është proceduar për në qeveri dhe në mbledhjen e parë të qeverisë do të kalojë si pikë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, në zyrën e ministrit kemi qenë bashkë dhe i kam thënë për urën e Shtrubullovës. Zhvilloni të gjitha procedurat ju. Temat me Dritonin dhe me shumë prej njerëzve këtu i kemi mbyllur dhe nuk jemi marrë vesh që këta të votojnë ashtu siç kërkon kryetari, por që çdo njeri të votojë sipas mendimit dhe vlerësimit të vet.

Driton Ajazi, kërkoi nga Egzona ta tërheqë fjalën "u shit e u ble dikush". Ai tha se duhet të ketë argumente kur i thotë këto fjalë, kur thirresh në parime, në mandatin e kaluar keni qenë pesë asamblistë, ndërsa në këtë mandat keni bërë koalicion me kolegun, sepse as pragun nuk do ta kishit kaluar si bartëse e listës. Pra, po shihen parimet e tua, ku ke mbetur vetëm ti si asambliste.

Xhavit Drenori tha se, ne si anëtarë të kuvendit, jemi të thirrur t'i përfaqësojmë qytetarët që na kanë votuar. Këta katër burra për të cilët e votuam deklaratën kundër vendimit të Gjykatës Speciale, kanë dhënë kontribut që ne në këtë vend të kemi demokraci dhe pluralizëm politik. Nuk është marre, të jesh në Vetëvendosje, Driton, sepse më shumë se gjysma e qytetarëve janë duke e votuar, duhet të kemi kujdes kur përmenden emrat e subjekteve politike.
Pikë të rendit të ditës kemi buxhetin komunal, si dokumentin më të rëndësishëm që duhet të diskutonët, i cili i prek direkt qytetarët përmes investimeve kapitale në zona të ndryshme. Ju lutem që të përmbaheni nga gjuha e fushatës.
Ne duhet të jemi të lumtur që kolegia jonë punon në ministri dhe realisht ka mundësi t'i shtyjë projektet përpara – një ndër to edhe projekti i urës, siç e tha edhe kryetari. Për të mos e ngarkuar buxhetin edhe ashtu të lodhur të Komunës, në këtë Kuvend ishte marrë vendim që të kalonte ajo pikë e rendit të ditës, për t'ia lënë ministrisë në dorë ndërtimin. Qytetarët që na kanë zgjedhur duan shërbime dhe përmirësim të infrastrukturës.
Unë kam marrë pjesë në dy dëgjime buxhetore dhe jam motivuar sidomos pas atij workshop-i që kemi mbajtur. Rëndësia e dëgjimeve buxhetore është e madhe, sepse ne si asamblistë shpesh nuk kemi kohë të shkojmë nëpër lokacione, por të paktën këtu në kuvend po na vijnë kryetarët e fshatrave dhe po i tregojnë hallet e tyre. Nëse ekzekutivi i mban dëgjimet vetëm sa për të plotësuar listën me shenja (tika) për shkak të grantit të performancës – të cilin ne e përkrahim sepse sjell të hyra shtesë – për ne, anëtarët e kuvendit, do të duhej të substancializohej ajo që thonë përfaqësuesit e lokacioneve. Aty kanë marrë pjesë vetëm katër a pesë asamblistë. Nëse sot asnjë anëtar i kuvendit nuk ngre asnjë çështje të një lokacioni të caktuar, realisht i bie që nuk jemi në gjendje të debatojmë këtu as për gjërat e tyre më elementare.
Z. Kryetar, ju nuk ishit në dëgjimet buxhetore kur i mbajtëm ne, respektivisht kuvendi dhe KPF-ja, me kryetarët e fshatrave, të cilët nuk ishin fort të kënaqur me projektet kapitale që po zhvillohen. Gjithmonë e kam pasur të njëjtin problem dhe do të vazhdoj ta kem, ne na duhet decentralizim i buxhetit dhe jo centralizim.
Ne e kemi kuptuar pse po bëhet kjo, bëhet për shkak të kodeve, sepse në qoftë se për secilin projekt caktohet një kod i veçantë, është një procedurë që zgjatet.
Unë do t'i kërkoja drejtorit të dalë e të na tregojë saktë se cilat kanë qenë projektet e planifikuara për vitin 2025 që ka përfunduar si vit buxhetor, cilat projekte nuk kanë mundur të realizohen dhe arsyet pse ka ndodhur kjo. A janë bartur ato me prioritet në këtë vit, në mënyrë që të dimë se për çfarë po flasim. Sepse nëse ne shkojmë 'blanko' dhe vetëm i votojmë, atëherë po ia lëmë krejtësisht në dorë ekzekutivit dhe vullnetit të tij ose të saj se ku do ta dërgojë projektin në një lokacion të caktuar.
Nëse nuk keni mundur t'i përfshini ato në këtë dokument, unë besoj që ne, si anëtarë të kuvendit, kemi të drejtë t'i kemi në një listë shtesë, ku dihet saktë se sa metra është dhe cili segment, sepse unë dje i kam pasur dy kërkesa nga banorë të ndryshëm.
Mendoj që duhet ta mbyllim debatin e hedhjes së topit nga një institucion në tjetrin, t'i kthehemi buxhetit dhe të flasim për secilin projekt. Ky dokument që na është sjellë nuk i ka ato specifikimet që më duhen mua si anëtar i kuvendit.

Më shkruajnë disa kryetarë fshatrash dhe më pyesin se çfarë vendimi morëm për lokacionin e tyre, unë vetëm ua fotografoj këtë pjesën me 150 mijë euro, por nuk di t'u them se cilat janë projektet konkrete. Ne na duhet, drejtor, një listë të cilën mund të na e dërgoni edhe me email pastaj për vitin 2027.

Mehedin Salihu tha se, ne kemi shumë probleme. Banorët e Drenasit nuk kanë ujë as për t'i larë sytë dhe nuk mund të shkojnë lirshëm në shtëpi sepse nuk funksionon ura. E përmendi edhe Dritoni që është një gropë e madhe para Shtëpisë së Shëndetit (QKMF), në vend që të ishte një park, si dhe shumë gjëra të tjera. Me një fjalë, me asnjë problem të banorëve tanë nuk u morët, vetëm e hodhët topin herë andej, herë këndej.
Edhe në mandatin e kaluar kam thënë që është mirë të specifikohet se sa kilometra shtrohen, po e zëmë në Vërboc - Shtuticë - Polluzhë, ose në cilën pjesë rinovohet, dhe jo 'blanko' kështu siç po e bëni deri më tani. Kështu, po t'ju dëgjojmë në shifra, jeni shumë të kënaqshëm, por konkretisht nuk po dalin ashtu siç po i projektoni. Unë kërkoj që të merremi med problemet konkrete të qytetarëve dhe jo me probleme të tjera që nuk na takon t'i diskutojmë në këtë kuvend.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, po e sqaroj pyetjen e Xhavitit dhe të Mehedinit në lidhje me shqetësimet e tyre. Për vitin 2026 raportojmë në fund të vitit për projektet të cilat i kemi përfunduar dhe për ato të cilat nuk janë përfunduar, e që i kemi pasur në buxhet, gjithashtu raportojmë se çfarë ka ndodhur me to dhe kush i ka marrë mjetet. Mehedin, jemi në kohën e ndryshimeve të mëdha ku janë rritur çmimet. Me dhjetëra herë ju kam thënë, merreni vesh për projektet investuese, ju mes vete vendosni se ku dëshironi t'i investoni ato mjete dhe unë do t'u kërkoj atyre që më dëgjojnë të votojnë ashtu siç merreni vesh ju, sepse çdo investim që bëhet, do të bëhet vetëm në Drenas dhe askund tjetër. Kështu që, të gjithë qytetarët e Drenasit ju kanë votuar juve dhe më kanë votuar mua. Ndërsa, nëse mjetet na i merr përmbaruesi nga ndonjë projekt, kjo është temë tjetër.

Xhavit Drenori, tha se për ta votuar këtë dokument, mua më duhet kjo lista e specifikuar për vitin e ardhshëm 2027. Aty ku është paraparë asfaltimi i rrugëve në fshatin X, të shihet se si i ka prioritetet. Nëse ma dërgon me email le të zotohet për këtë, unë e votoj, përndryshe dokumenti është shumë i përgjithshëm dhe nuk mund ta votoj.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e tretë. **Pika (3) Propozim-Buxheti i Komunës për vitin 2027 dhe projeksionet për vitet 2028-2029.** Për votuan 24, kundër 1, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e katërt.**Pika (4) Propozim-Vendim për plotësim-ndryshimin e pikës 1 të Vendimit Nr. 020/04-11325 të dt.30.03.2026 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL "Eko-Drenasi" Sh.a.** Ky ndryshim bëhet si rezultat i tërheqjes së një anëtari, Xhavit Drenori, i cili ka dhënë dorëheqje për arsye personale dhe profesionale. Kështu që, ky anëtar duhet të zëvendësohet dhe të propozohet një anëtar i ri.

Xhavit Drenori, në arsyetimin e tij, tha se, i kam cekur dy arsye. E para, punën ne si komision komunal e kemi kryer teknikisht më përpara e kemi bërë statutin dhe kemi zgjedhur bordin e

përkohshëm. Tani ka mbetur puna që duhet ta kryejnë ata. Unë nuk mund ta përcjell punën e tij për shkak të obligimeve që kam marrë, sepse jam edhe në gjashtë komisionc të tjera. Gjatë punës e kemi parë se do të duhej të ishte drejtori Nexhmedin Gruda, sepse kjo është në fushëveprimtarinë e tij dhe jo drejtoresha. Në këtë NPL, shumica e kompetencave kalojnë nga drejtoria ku është drejtori Nexhmedin Gruda. Thjesht është një çështje teknike, nuk është asgjë tjetër.

Gani Krasniqi, propozon Naim Gjelin si anëtar të komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, tha se komisioni përbëhet nga:
Laureta Thaçi (anëtare nga ekzekutivi)
Naim Gjeli (anëtar nga kuvendi)
Driton Ajazi (anëtar nga kuvendi)
Me këto propozime, ai e hodhi në votim pikën e katërt. Për votuan 26, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e pestë.
Pika (5) Propozim-Vendim për vazhdimin e zbatimit të rendit ekzistues të udhëtimit për operatorët e transportit publik të udhëtarëve me autobus në Komunën e Drenasit, për linjat urbano-periferike.

Egzona Tërdevci tha se, në material nuk e kam parë rendin e udhëtimeve. A mund ta dimë se si është ky rend udhëtimesh.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, theksoi se bëhet fjalë për rendin aktual. Arsyeja pse nuk e kemi bërë ende rregullorcn është se unë nuk kam të drejtë t'ua vazhdoj atë. Përndryshe, nëse nuk ua vazhdojmë, ata nuk kanë të drejtë të operojnë. Domethënë, kuvendi e vazhdon orarin aktual derisa të zhvillohen procedurat e tjera.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hodhi në votim pikën e pestë. **Pika (5) Propozim-Vendim për vazhdimin e zbatimit të rendit ekzistues të udhëtimit për operatorët e transportit publik të udhëtarëve me autobus në Komunën e Drenasit, për linjat urbano-periferike**. Për votuan 26, kundër 0, abstenim 0.

Pas votimit të pikës së pestë, **Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi,** kërkoi një pauzë dhe njoftoi asamblistët që të kthehcshin në sallë në orën 13:00.
Në orën 13:32, mbledhja vazhdoi me pikën e gjashtë.
Pika (6) Propozim-Vendim për shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesës së parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, konstatoi kuorumin (të pranishëm ishin 26 anëtarë) dhe e hapi këtë pikë për diskutim.

Egzona Tërdevci tha se, është e vërtetë që kemi kërkuar edhe në muajin e kaluar ta shtyjmë këtë pikë për mungesë informatash. Për mua personalisht ka shumë paqartësi të kjo çështje.

Nga pala jemi njoftuar se është thirrur një seancë gjyqësore më 6 tetor, prandaj prapë do të kërkoja ta shtyjmë këtë pikë deri pas kësaj date. Diskutimin tim nuk po e bëj politik, por pse kjo pronë, nëse është ditur që është e Komunës, nuk është përdorur kurrë që nga viti 2019. Pse po bëhet tani, kur është ndërtuar çerdhja e re. Për çerdhen e vjetër është njëfarë sekreti publik që flitet rrugëve se do të përdoret për ndërtim të lartë, e aty është edhe Qendra për Punë Sociale, që dikujt mund t'i konvenojë (përshtatet) të largohet si objekt e të përdoret për ndërtim të lartë. Kjo temë ka shumë pikëpyetje.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se dua të të demantoj dhe të tregoj për temën se do të bëhet ndërtim i lartë të çerdhja e vjetër. Nuk është hera e parë që e kam shpjeguar, ajo pronë atje është pjesë e parkut dhe e sheshit, madje një pjesë e madhe e saj tashmë është marrë dhe pritet të pastrohet e të bëhet shesh. Sa të jem unë kryetar, kurrë nuk kam për ta sjellë atë pronë për ndërtim të lartë, përveçse për shërbim të qytetarëve si shesh, park etj., prandaj mos provoni ta mashtroni opinionin. Kurse për pikën e gjashtë, në dorën tuaj është vetëm t'i zgjatni ose t'i shpejtoni procedurat, ose ta ndihmoni Komunën për pronën publike.

Egzona Tërdevci tha se, unë nuk të akuzova, por vetëm e ngrita si pyetje. Po më vjen shumë mirë që nuk e ke në plan ta japësh për ndërtim; kam për të të mbajtur për fjalë që po thonë se ka për të mbetur në shfrytëzim të qytetarëve, edhe pse e sjell në Kuvend për ta dhënë në shfrytëzim. Te lista e veçantë, prona me numër 768-1 ka qenë pjesë e diskutimeve në vitet e kaluara, por nuk ka kaluar. Por, nëse pala na ka sjellë një listë poseduese ku prona figuron komplet si e tij, ndërsa ne e kemi edhe një fletë poseduese të Komunës, këtë anomali nuk po e kuptoj dhe po kërkoj me mirëkuptim ta presim seancën e 6 tetorit që t'i japë një epilog kësaj çështjeje, qoftë në favorin tuaj si Komunë, qoftë në favor të palës.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se listën e përgjithshme të pronave e qesim në uebsajt, ajo është temë tjetër. Më gjej diku këtë pronë të caktuar te sheshi, domethënë askund nuk e gjen. Kërkoj nga kryesuesi t'i lejojë dy zyrtarët e Komunës që të sqarojnë temat për të cilat po ka dyshime që nuk është pronë e Komunës, por e dikujt tjetër.

Altina Mulaj Hajdini theksoi se, që nga mbledhja e kaluar kemi qenë të hapur si zyrë për të ardhur e për t'i diskutuar të gjitha paqartësitë, por deri më sot asnjë anëtar i Kuvendit nuk ka ardhur për të pasur një pasqyrë më të qartë të çështjes. Më tej, ajo tha se është bërë një propozim për masë të sigurisë, mirëpo masë të sigurisë në fuqi nuk ka dhe, kushtimisht, me këtë nuk ka ndonjë ndalesë. Propozimi për masë të sigurisë nuk do të thotë detyrimisht ta pezullosh çdo procedurë administrative. Pala e ka bërë masën e sigurisë, ka pasur edhe të drejtën të bëjë precizimin e masës së përkohshme. Gjykata në këtë rast ka mundur drejtpërdrejt, pa ia dhënë të drejtën Komunës, të kërkojë masë të përkohshme të sigurisë brenda tri ditëve; neve të na japë të drejtën t'i japim qëndrimet tona pas afatit triditor, brenda tri ditëve të caktojë edhe seancën, edhe vendimin për masa të përkohshme të sigurisë ta zëvendësonte me një vendim tjetër, që në këtë rast nuk është. Komuna është person juridik në këtë rast dhe si person juridik ka mjete të mjaftueshme. Domethënë, në rastin konkret, e gjithë çështja është te kompensimi i pronës, ku pala në fjalë thotë që nuk i është kompensuar prona. E kemi cekur edhe në mbledhjen e kaluar që prona 391-1 është pronë e palës, kurse 391-5 dhe 381-1 janë prona shoqërore dhe nuk kemi asgjë kontestuese cu pronën e tij. Nga diskutimi në seancën e kaluar, çështja e ekspropriimit ka

mbetur diskutabile edhe në kohën e para luftës, pasi palët nuk janë pajtuar me shumën që u ka ofruar institucioni; ne i kemi thënë ta bëjë në gjykatë, nuk e ka bërë pala dhe e ka humbur të drejtën. Pala na ka dorëzuar një dokument me të cilin pretendon se ka kërkuar kompensimin, por realisht ky aktvendim nënkupton tërheqje të propozimit. Pala ka bërë një propozim për kompensim për shumën e caktuar, por të njëjtin e ka tërhequr dhe automatikisht tërheqja nënkupton aprovim të procedurës së ekspropriimit, domethënë u pajtua pala me kompensimin nga Komuna. Sa u përket procedurave gjyqësore, nuk ka një vendim të masës së sigurisë që juve sot jua ndalon vendimmarrjen; propozimi për masë të sigurisë palës kundërshtare ia jep 7 ditë afat për përgjigje, ne ia kemi ofruar. Por, nëse pala e bën një kërkesë të paarsyeshme dhe me të dëmtohet personi kundërshtar, në këtë rast ne si institucion, atëherë edhe ne e kemi të drejtën e kompensimit për këtë çështje.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se ne asnjëherë nuk kemi deklaruar se a ia ka paguar Komuna a nuk ia ka paguar pronën, por kurrë pala nuk mund ta kthejë pronën që ia ka marrë Komuna.

Safet Hoxha, shef i Gjeodezisë, tha se pronari gjatë javës së kaluar ishte në zyrë dhe kishte sjellë regjistër të paraqitjes; nuk e di ku e ka siguruar këtë regjistër. Ai e kundërshton mendimin që kemi jepur ne dhe ashtu siç është në mënyrë profesionale, nëse i referohemi regjistrit, realisht prapë është pronë komunale. Parcela 391-5 është pronë komunale; parcela 391, e cila është parcelizuar në 391-5, e ka sipërfaqen 20 ari, por prapë parcelës 391-1 i ka mbetur i ruajtur numri me sipërfaqe 17.93 ari. Ai pretendon që leja ndërtimore i është dhënë parcelës 391, ndërsa ne po e kundërshtojmë sepse realisht është pesëshi. Ne kemi dëshmi edhe fakte. Egzona iu referua që ka fletë poseduese, por ky është vetëm një regjistër i paraqitjes, nuk ka fletë poseduese për të."

Egzona Tërdevci tha se, dokumenti që e kam unë është listë poseduese, ku prona 391-1 figuron në numrin e plotë prej 37.93 ari. Pra, është shuma e pronës që përfshin 391-1 dhe 391-5. Qysh ka mundësi që për të njëjtën pronë të jenë dy fleta poseduese të ndryshme? Në këtë rast, kjo listë poseduese tregon që 37 ari janë komplet të posedues it, sipas pretendimeve të palës të vitit 2000. Po ju po thoni që qe 40 vite ju ka marrë prona. Qysh ka mundësi që në vitin 2000 të nxirret një listë posedues e ku prona figuron në pronësi të palës, ndërsa në vitin 2026 lista posedues e të jetë pjesërisht e Komunës dhe pjesërisht e palës? A mundesh në aspektin profesional të na e sqarosh? Nëse dokumenti nuk është i vërtetë, a mundesh të na prezantosh dokumentin e vërtetë.

Safet Hoxha, shef i Gjeodezisë, tha se prej vitit 1999 është pronë komunale dhe, nëse e ka lëshuar dikush një fletë poseduese me dorë, ka mundësi ta ketë bërë gabim ndonjë zyrtar. Por, kjo është gjendja që argumentohet edhe në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, edhe në zyrën kadastrale që është te ne. Prej vitit 2013 që jam këtu si zyrtar, nuk kemi rast që Komuna e ka humbur ndonjë pretendim, ku pala ka pretenduar që prona që ka qenë e tij i ka kaluar Komunës dhe që ai e ka fituar kontestin në gjykatë. Me përgjegjësi të plotë e them: profesionale, ligjore edhe morale.

Xhavit Drenori tha se, këtu janë dy çështje, ju që thoni se e keni një fletë poseduese që 40 vite, dhe në anën tjetër ai ka ofruar një dokument që është i vitit 2000 me vulë të UNMIK-ut. A mundesh të na gjesh se kush janë këta që i kanë nënshkruar këto dokumente.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se agjencia Kadastrale e Kosovës, nëse e ka lëshuar këtë dokumentin e vitit 2000, ju po harroni që një zyrtar për 12 vite ka nënshkruar edhe në emër të vetin, edhe në emër të drejtorit të kadastrit.

Liman Krasniqi tha se, në aspektin kadastral jemi në rregull dhe nuk e kemi asnjë kontest, por ne presim sqarime në aspektin juridik.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se në vitin 2000 ne t'ia kemi marrë dhe i kemi bërë të gjitha veprimet, pala i ka pasur 26 vite kohë për t'i dërguar e për t'i ndjekur procedurat për pronë. Por, brenda 10 viteve, në qoftë se nuk i ka ndjekur procedurat, ai edhe po të kishte qenë prona e tij, e ka humbur pronën ligjërisht, kështu që vetëm jeni duke humbur kohë.

Safet Hoxha, shef i Gjeodezisë, iu drejtua Xhavitit duke thënë se si ka mundësi të jenë dy fleta poseduese. Në kadastër është ligj dhe parim që çdo fletë poseduese që e ka një pronar duhet të regjistrohet në RDPP (Regjistri i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme). Përderisa nuk është e regjistruar në RDPP, nuk mund ta marrim si valid atë regjistër. Nëse ndonjë zyrtar ka bërë ndonjë lëshim ose gabim, ai mban përgjegjësi juridike dhe ligjore, kështu që ne flasim për dokumentacionin zyrtar që e kemi në RDPP.

Arbër Halilaj, tha se unë nuk jam këtu për t'u pozicionuar as në anën e palës, as të Komunës, mirëpo kur ka kësisoj ballafaqimi të dokumenteve, parimisht jam që mos të mbibendosemi mbi gjykatën. Po ndërlidhem me aspektin ligjor: nëse kalojnë 10 vite dhe s'ke bërë ankesë, a do të thotë që parashkruhet dhe e humb të drejtën në atë pronë? Meqenëse është cekur seanca, nuk e gjej nëse edhe gjykata nuk e ka urgjente të marrë masa të përkohshme, nuk e di pse kemi ne urgjencë në kërkesën tonë, që nuk mund ta shtyjmë këtë çështje në vazhdimësi. Unë publikisht deklaroj që, nëse nuk merret masa e përkohshme, unë votoj për vazhdimin e çështjes sonë, ndërsa gjykata le t'i vazhdojë procedurat e veta e le të marrë vendim, sepse si të votojmë për, si kundër, vendimi final do të jetë i gjykatës, jo i Asamblesë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se e thashë edhe një herë, është një procedurë që është zhvilluar, ai nuk i ka zhvilluar procedurat edhe pas luftës dhe, edhe një herë po e përsëris, e ka humbur të drejtën.

Xhavit Drenori tha se, sot po binden edhe më shumë që kjo pronë është e Komunës. Të ndëruar kolegë, zyrtarja na e sqaroi se për çka mbahet seanca gjyqësore. Ne si anëtarë të Kuvendit nuk besoj që duhet ta presim vendimin e gjykatës, sepse nëse sot ne e marrim këtë vendim, vendimi ynë shkon në MAPL (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) dhe asnjë veprim Kryetari i Komunës nuk mund të bëjë derisa të kthehet ligjshmëria nga MAPL-ja. Dhe, në qoftë se gjykata ka marrë vendim që të merret masë sigurie, ajo pronë ka për të mbetur pa u prekur, pa marrë parasysh vendimin tonë, dhe vendimi ynë mbetet pezull (*pending*) derisa gjykata t'i përfundojë të gjitha procedurat dhe t'i japë një epilog se e kujt është ajo. Edhe pse për pronë prapë po pajtohemi që nuk ka shanse t'i kthehet pronarit, vetëm kontestuese është nëse kompensimi i është dhënë a s'i është dhënë. Në qoftë se ne e shtyjmë këtë pikë dhe gjykata s'ka marrë asnjë vendim,

ata që e kanë pasur ndërmend t'ia mbajnë anën palës do ta mbajnë prapë, ndërsa pjesa tjetër kanë për të vepruar sipas këtyre dokumenteve.

Arbër Halilaj tha se, përkundër asaj që tha Xhaviti, unë sot votoj kundër, ndërsa në seancën e tetorit, nëse vjen kjo pikë e rendit të ditës, e votoj për të kaluar, për arsye se jemi 11 ditë para një seance ku diçka përcaktohet. Nëse gjykata e ka konstatuar që nuk është urgjencë, as unë nuk e shoh si urgjencë. Desha ta pyes zyrtaren se a do të thotë që çështjet pronësore parashkruhen.

Altina Mulaj Hajdini, zyrtare ligjore tha se aktgjykimi që ju është dhënë përpara është si analogji e një rasti të ngjashëm, domethënë janë të obliguar që të kenë versione të njëjta të vendimeve. In rastin konkret, 10 vjet është afati për ta kërkuar të drejtën me dhunë për pronën e vet, për të cilën nuk është pajtuar me procedurën e eksproprijimit. Dhe në këtë rast, çështja ka mbetur vetëm te kompensimi, sipas pretendimeve të palëve, e që tani me dokumentin e tyre po del që këta e kanë bërë propozimin në gjykatë por e kanë tërhequr, me pretendimin se pronën e vet e kanë në pronësi të tyre dhe që janë duke e shfrytëzuar.

Xhavit Drenori, tha se unë i kam disa pyetje. E para: nëse ne sot marrim vendim për, a bën ndonjë veprim ekzekutivi në atë pronë derisa të kthehet ligjshmëria. E dyta: nëse më 6 tetor gjykata e nxjerr një masë të sigurisë, a i nënshtrohet këtë obligimi ligjor të atij vendimi ekzekutivi i Komunës.

Liman Krasniqi, tha se edhe një herë po e përsëris në aspektin kadastral jemi në rregull dhe nuk e kemi asnjë kontest, por ne presim sqarime në aspektin juridik. Aktvendimi i vitit 1977, kur zotërisë i është eksproprijuar toka, i është marrë për një qëllim të caktuar, për objekte të caktuara, dhe nuk është ndërtuar asgjë tash e 40 vite. Sepse ai zotëria nuk po e konteston kompensimin, por po thotë 'mos më merrni tokën sepse e kam shtëpinë dhe familjen aty'. Ai thotë që ia kanë eksproprijuar tokën pa pëlqim. Derisa një subjekt juridik si Kuvendi, konkretisht Drejtoria e Urbanizmit, që e ka marrë për qëllim të caktuar, për objekte të caktuara, dhe nuk e ka shfrytëzuar një tokë që ia ka marrë një pronari për një periudhë 10-vjeçare, ku kanë qenë të drejtat dhe kompetencat e Kuvendit Komunal dhe ku kanë qenë të drejtat dhe kompetencat e pronarit, të cilit i është marrë toka me dhunë sepse nuk ka pranuar kompensim.

Altina Mulaj Hajdini, zyrtare ligjore, thotë se është vetë pala ajo që ua ka dhënë vendimin për eksproprijim (shpronësimit). Tani ne nuk mund ta prejudikojmë çështjen kryesore të gjykatës; është gjykata ajo që vendos. Komuna është person juridik dhe e ka kapacitetin për kompensim për çdo lloj dëmi që mund ta vërtetojë gjykata për palën. Gjëja më kryesore është se ju, si anëtarë të Kuvendit, nuk keni një masë të sigurisë në fuqi; domethënë, ndalesë prej gjykates për të votuar ose mos për të votuar nuk keni. Dhe, përderisa nuk keni, propozimi për masë të sigurisë detyrimisht nuk nënkupton pezullimin e proceduravc administrative.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se e thashë edhe më herët, nëse një herë eksproprijohet kjo pronë, ajo nuk i kthehet më pronarit kurrë. Është puna juaj nëse votoni pro, kundër apo abstenoni, pra ju vendosni.

Driton Ajazi, i falënderoj zyrtaret për argumentet që i dhanë, sepse kur po i ballafaqojmë dokumentet nuk po kemi dyshim se kush ka të drejtë. Argumentet qëndrojnë që Komuna është pronare e parcelës. Por, që të hiqet çdo dyshim dhe aludim i secilit anëtar të Asamblesë, po edhe i secilit qytetar e i pretenduesit të pronës, e them hapur që i kemi parë argumentet e të dyja palëve. Ne nuk jemi gjykatë për t'i dhënë përparësi njërës apo tjetrës palë, por edhe ne duhet të vendosim mbi bazën e dokumenteve të ofruara. Unë e them publikisht që, kur të kalojë data 6 tetor dhe të mbahet ajo seancë, ku vendoset nëse do të ketë masë të sigurisë apo jo, në seancën e tetorit unë do të votoj pro mbrojtjes së pronës publike. Por, në rastin konkret, kërkoj me mirëkuptim që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, tha se pas debatit për pikën e gjashtë të rendit të ditës, kërkoj 5 minuta pauzë me shefat e grupeve kuvendare." Pas pauzës, ata u dakorduan që pika 6: Propozim-vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të parcelës nr. 391-5 dhe pjesës së parcelës 381-1 ZK Drenas, për nevojat e Qendrës për Punë Sociale – Drenas, *të* shtyhet për seancën e radhës. Kryesuesi e hodhi në votim këtë propozim; të pranishëm ishin 27 anëtarë. Për votuan 25, kundër, 2, abstenim, 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e shtatë. **Pika (7) Raporti i progresit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2025.**
Pasi nuk pati diskutime, ai vazhdoi me pikën e tetë.
Pika (8) Raporti i të dhënave për performancën komunale për vitin 2025.

Egzona Tërdevci, tha se edhe pse treguesit janë përgjithësisht mirë, mendoj që janë disa pika ku kemi dalë më keq dhe që janë shqetësuese. Është pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime publike, ku kemi marrë pak pikë, po ashtu, shqetësues është edhe moszbatimi i rekomandimeve nga auditimi i brendshëm. Pastaj, për fëmijët që vijojnë kopshtin, numri është shumë i ulët; po ashtu, është i ulët treguesi i rrugëve me trotuare. Besoj që në vitin e ardhshëm duhet të punojmë që këta tregues të përmirësohen.

Xhavit Drenori, tha se të çështja që ngriti kolegja, ne si anëtarë të Kuvendit kemi pasur një seminar (workshop) para një muaji në Brezovicë. Kemi bërë edhe grupe punuese me asamblistë se si mund t'i informojmë qytetarët për të marrë pjesë në dëgjime buxhetore, prandaj kjo duhet të jetë një vërejtje e përbashkët, jo vetëm e ekzekutivit.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se e falënderoj ekipën e performancës komunale, të cilët na bëjnë krenarë duke qenë kampionë për performancë të mirë. I falënderoj edhe asamblistët për kontributin që kanë dhënë. E kemi diskutuar disa herë që pikët i humbim për shkak të trotuareve, numrit të vogël të fëmijëve në kopshte dhe mospjesëmarrjes në dëgjime publike. Nuk e di se çfarë të bëjmë më shumë sesa t'i lutim njerëzit të vijnë në dëgjime publike. Raporti i auditorit na del i keq për shkak të kontratave kolektive.

Egzona Tërdevci, e falënderoi kryetarin për sqarimet, por shtoi treguesi ishte për auditimin e brendshëm, jo për auditimin e jashtëm. Treguesi tregonte që ju, si ekzekutiv, nuk i merrni parasysh rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Kamer Rama, auditor i brendshëm, tha se, është e vërtetë se implementimi i rekomandimeve gjatë vitit 2025 është 40 pikë e diçka për qind, për arsye se në asnjë institucion nuk mund të arrihet ndonjë shkallë më e lartë. Vetë Zyra Kombëtare e Auditimit në ministri i ka shifrat deri në 39%, ndërsa komunat 40-43%. Në numërim hyjnë vetëm rekomandimet që janë të implementuara 100%. Ne, prej të gjitha rekomandimeve që kemi dhënë, kemi pasur 20 rekomandime që janë implementuar 100% dhe 19 që janë implementuar pjesërisht; domethënë, edhe pse disa janë në proces, ato nuk na numërohen. Puna dhe rezultatet tona nuk mund të inkorporohen të gjitha në raport përderisa nuk janë të implementuara 100%.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim pikën e nëntë. **Pika (9) Propozim-vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.** Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë, dy nga ekzekutivi dhe dy anëtarë të Kuvendit, si dhe një nga shoqëria civile.

Gani Krasniqi, nga PDKRLL-ja propozon Burim Bujupin si anëtar të komisionit.
Pajtime Berisha, nga PDK-ja propozon Driton Ajazin si anëtar të komisionit.
Anëtarë nga ekzekutivi: Petrit Gashi, Dafina Leku.
Anëtare nga shoqëria civile: Rina Gashi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Burim Bujupi, hodhi në votim pikën **(9) Propozim-vendim për formimin e Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, me përbërjen e lartpërmendur.**
Për votuan 22, kundër 0, abstenime 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim. Pikën (10) Propozim-vendim për formimin e Komisionit të Ankesave, i cili do të shqyrtojë ankesat e palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
Kryetari propozoi nga ekzekutivi për anëtarë të komisionit:
Vlora Zuqaku-Morina dhe Besart Bajrami.
Gani Krasniqi nga PDKRLL, propozoi Erblina Morinën si anëtare nga Kuvendi.
Driton Ajazi nga grupi i PDK-së, propozoi Egzona Tërdevcin si anëtare nga Kuvendi.
Nga shoqëria civile u propozua Mehdi Ademi.
Kryesuesi hodhi në votim. Për votuan 21, kundër 0, abstenim 0.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim. **Piken (11) Pyetje dhe përgjigje.**

Egzona Tërdevci, pyet për rrugën "Xhevë dhe Fehmi Lladrovci". A ka me pasë edhe shtresë tjetër, a është shtresa e fundit kjo që është shtruar, sepse shiriti që vjen prej Gllobarit në drejtim të Drenasit nuk është punuar mirë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se a është punuar mirë a jo, e përcakton komisioni i pranimit të projektit. Nuk kam informacion a ka me u shtruar edhe një

shtresë në një segment të rrugës në drejtim të OP Drenicës, për shkak se pronarët janë në kufi të pronës komunale.

Xhavit Drenori, tha se shumë qytetarë po e pyesin për urën e Shtrubullovës. A mundemi me t'i vendosur ministrit një afat kohor për t'i bërë presion deri më një datë të caktuar, për arsye se ura është në gjendje të keqe dhe në momentin e të reshurave të para mund të shembet krejt, prandaj nuk kemi kohë për të humbur.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se, unë kam biseduar me dy drejtorët e mi, Endritin edhe Nexhin, se si të gjejmë zgjidhjen e mjeteve për demolimin e urës. Pastaj, pasi ta demolojmë, të shohim mundësinë me FSK-në për ta bërë një urë, e cila do të jetë derisa të procedohet me të tjerat.

Mërgim Pirraku, ngriti një shqetësim nga qytetarët e fshatit Sankoc dhe Komoran lidhur me groposjen e mbetjeve të kafshëve në një vend të quajtur Quka "Ata kanë pyetur se a ka mundësi të shqyrtohet mundësia për të ndërruar lokacionin, pra të vendoset në një lokacion më larg vendbanimeve. Ata shqetësohen se mos po shkaktohet ndonjë problem shëndetësor në të ardhmen ose ndotja e ujërave që janë afër atje. Unë kam biseduar edhe me kryetarin, edhe me kryesuesin, por e ngrita si çështje edhe pa mikrofon për të dëgjuar edhe qytetarët që po na dëgjojnë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se është e vërtetë që kemi qenë në takim dhe kemi biseduar, edhe për ujin e pijes. Nuk ka asnjë rrezik të epidemisë, sepse të gjitha procedurat e varrimit të kafshëve janë në harmoni me ligjin. Ne e kemi bërë një varrezë që të mos bëjmë 10 varreza, sepse nuk kemi alternativë tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, hapi për diskutim **Pikën (12) Të ndryshme.**

Tringa Bujupi paraqiti disa kërkesa të banorëve të fshatit Arllat, të cilat ata i kanë dorëzuar në Komunën e Drenasit përmes administratës së fshatit dhe më kanë kërkuar që t'i ngre edhe unë në këtë seancë. Kërkesat janë:
1. Rregullimi i gropave septike për ujërat e zeza në lagjen Foniqi dhe në lagjen e Xhamisë.
2. Për parcelat 657-0 dhe 658-0, ku përfshihen varrezat e lagjeve Bujupi dhe Kodrali, të shqyrtohet mundësia që të dedikohen për varreza, si dhe të bëhet rrethimi i tyre.
3. Rregullimi i rrethrrotullimit në rrugën "Agim Qela", që lidh Arllatin me Malishevën. Meqë rruga është duke u asfaltuar nga nivelli qendror, kërkohet që kjo çështje të përcillet edhe në ministrinë përkatëse, nëse është e nevojshme.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se ata pronarët më kanë humbur buxhetin të cilin e kam pasur të caktuar, nuk më kanë lënë të bëj gropa septike. Po u sqaroj të gjithë qytetarëve përmes kësaj seance që çdo qytetar që për një kohë e pengon një projekt, i ka humbur ato mjete të cilat kanë qenë të parapara dhe janë kthyer në buxhetin e Kosovës. Jemi duke provuar të bëjmë më të mirën kur të merren vesh, ne e zgjidhim këtë problem. Sa i përket rrethrrotullimit, është e njëjta situatë si te QMF-ja në Komoran, është pronë e qeverisë, neve nuk na lejohet ta bëjmë. Për rrethimin e varrezave ne e kemi një buxhet që e kemi përcaktuar.

Afrim Prokshi tha se për këtë vit është ndarë buxhet për varreza në tri lokacione. Poklek, Shtuticë dhe një pjesë në Zabel të Ulët, ndërsa për vitin e ardhshëm janë të planifikuara 20 mijë euro dhe prioriteti do t'i jepet këtu nga kuvendi edhe kryetari. Në Arllat, që e përmendi kolegia, është bërë rrethojë në vitin e kaluar në atë hapësirë ku është lejuar të bëhet rrethimi i varrezave.

Pasi nuk pati pyetje as diskutime të tjera, **kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi,** e shpalli mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 15:55

Kryesuesi i Kuvendit

Burim Bujupi

Procesmbajtësja: Fakete Hoti

Lekturoi: Nikelinda Bujupi

Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës

02 Nr. 060/04-42779 dt. 08/10/ 2026

PROCESVERBAL

I mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit, të mbajtur më 09.09.2026.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Burim Bujupi, i cili deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme. Në sallë ishin të pranishëm 16 anëtarë.

Të pranishëm në mbledhje ishin: Kryesuesi i Kuvendit, Burim Bujupi. Anëtarët e Kuvendit: Ekrem Elshani (PDK), Valdet Curri (PDK), Erblinë Morina (PDK), Fitore Morina-Hoxha (PDK), Edon Nishori (PDK), Qëndresë Xhema (PDK), Driton Ajazi (PDK), Mërgim Pirraku (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Muhamet Xhemajlaj (PDK), Pajtime Berisha (PDK), Luljeta Elshani (PDK), Tringa Bujupi (PDK), Xhavit Drenori (GREEN), Liman Krasniqi (NISMA).

Munguan: Naim Gjeli (PDK), Anjeza Kurtaj (PDK), Selman Qallapeku (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Arigon Sinani (PDK), Jahir Hajdari (PDK), Egzona Tërdevci (VV), Arbër Halilaj (BD), Mehedin Salihu (Për Drenas e për Kosovë), Egzon Qorri (LDK), Artian Krasniqi (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Arben Shala, stafi i Zyrës së Kryetarit, drejtorët e drejtorive komunale, si dhe përfaqësuesi nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), Instituti GAP, ATRC dhe CBM ka nisur procesin e monitorimit të performancës së anëtarëve të kuvendeve komunale.

Mbledhja do të ketë këtë:

REND TË DITËS

1. Rrezikimi i shëndetit publik, në veçanti në shkolla, si pasojë e mungesës së tejskajshme dhe alarmante të furnizimit me ujë të pijshëm, si rezultat i mosriparimit të pompave në Bivolak të Vushtrrisë nga ana e KRU "Prishtina", mosfunksionalizimit të burimeve sekondare të ujit në territorin e Komunës së Drenasit (Krajkovë, Gjergjicë, Arllat, Kishnarekë, Baicë, Sankoc), si dhe mostrajtimit të investimeve të Komunës nga ana e KRU "Prishtina" për ujin e pijes në fshatrat e Komunës së Drenasit. Me qëllim të informimit të qytetarëve për çështjen e furnizimit me ujë, kundërshtimit të gjendjes së rënduar, rrezikimit të shëndetit publik për mungesë të ujit të pijes dhe sfidës së fillimit të vitit të ri shkollor, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Drenasit ftohen përgjegjësit e KRU "Prishtina" për të na informuar rreth gjendjes së furnizimit me ujë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, në fjalën e tij të rastit në seancën e jashtëzakonshme për çështjen e furnizimit me ujë të pijes – të mbajtur në Kuvendin e Komunës së Drenasit – u shpreh se, kjo mbledhje nuk ka motive politike. Nuk ka qëllim të atakojë nivelin qendror as rajonin e Prishtinës. Kjo seancë është e ftuar për të dëshmuar gjendjen e rëndë të qytetarëve të Drenasit. Në fillim kërkoj mirëkuptim dhe besimin e qytetarëve se ne, me të gjitha mundësitë, jemi në shërbim të interesit tuaj. Kam deklaruar se i garantoj qytetarët për ujë të pijes 24 orë. E kam deklaruar se të gjitha përgjegjësitë tona rreth furnizimit me ujë i kryej me përgjegjësi të plotë, në kohën sa më të shkurtër, si prioritet i qeverisjes tonë lokale. Dua të pyes. A ka qëllim të keq dikush kundër qytetarëve të komunës së Drenasit. Drenasi nuk ka ujë. Drenasi nuk meriton këtë trajtim. Ka kohë që sfida e ujit jo vetëm nuk po zgjidhet, por ka kohë që kur ndodh një rreshje shiu, sado e vogël, ndërpritet uji me ditë të tëra për të gjithë qytetarët. Në shekullin XXI Drenasi po e bartë sfidën e mungesës së ujit. Kjo gjendje është e padurueshme. Ne kishim mirëkuptim për vështirësitë e KRU "Prishtina". Ne kishim mirëkuptim për defektet në procesin e furnizimit me ujë, por kjo e ka tejkaluar çdo kufi. Drenasi është i diskriminuar me mungesë të ujit. Qytetarët e Drenasit po i bartin pasojat. Mirëqenia e qytetarit është e lidhur ngushtë me furnizimin me ujë. Furnizimi nuk po ndodh, s'po bëhet, s'po kryhet. Uji mungon, ndërsa prej disa viteve e kemi sinjalizuar nivelin qendror se pompat e Bivolakut, jo vetëm se janë të amortizuara – mbi dyzet vjet në përdorim – por edhe të papërdorshme për nga kapacitetet e planifikuara për furnizimin me ujë.
Ne kemi investuar për infrastrukturë, por pompat është e pamundur t'i aftësojmë edhe për faktin se janë në komunë tjetër dhe është çështje vetëm e nivelit qendror. Prioritet i qeverisjes lokale është furnizimi me ujë. Kujt i shërben kjo mungesë. Pushteti lokal i ofron ndihmë e përkrahje KRU "Prishtinës", por nuk mund të shndërrohet në kompani e cila me ligj obligohet të bëjë furnizimin me ujë të pijes për qytetarët e komunës së Drenasit. Ne kemi bërë krejt çka është e mundur për të angazhuar kapacitetet alternative për furnizim me ujë. Përkundër kapaciteteve dytësore të rezervave të ujit, si në Krajkovë, Baicë, Arllat, Llapushnik, Kizhnarekë, Gjergjicë, Kroi i Mbretit, Sankoc. KRU "Prishtina" i ka lënë jashtë funksionit këto burime, me gjithë investimet nga Komuna e Drenasit, investime të cilat nuk i takojnë Komunës. Në tre vitet e fundit, kur u hap mundësia e vazhdimit të punës për sigurimin e ujit të pijshëm, janë investuar rreth tre (3) milionë euro në gypat primarë e sekondarë të ujësjellësit dhe janë kryer mbi 3.000 kyçje të ekonomive familjare në ujin e pijshëm. Janë ndërtuar nga komuna edhe stacione

pompimi, janë bërë madje edhe pagesa të energjisë elektrike nga komuna. Sigurimi i ujit të pijes bëhet nga Kompania e Ujësjellësit Rajonal "Prishtina" dhe komuna apo pushteti lokal mund t'i ofrojë vetëm përkrahje në infrastrukturë, punë të cilën e kemi bërë me investime të vazhdueshme. Po ashtu, deri më tani kemi ndërtuar mbi 100 kilometra kolektorë përgjatë lumenjve Drenica e Vërbica dhe mbi 400 kilometra rrjet sekondar të kanalizimit, puna për Drenasin kampion nuk ndalet. Punët tona shihen, punët tona vazhdojnë. Çështja e ujit të pijes dhe ujërave të zeza është fushëveprimtari e KRU "Prishtina" dhe e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe presim që kjo sfidë, si asnjëherë më parë, të trajtohet me prioritet. Investimi në ujin e pijes është investim për jetën e qytetarëve. Rrezikimi i shëndetit publik, në veçanti me fillimin e vitit të ri shkollor, pa ujin e pijes, është çështje që tejkalon sërish kompetencën e komunës. Anulimi i mësimit nuk është zgjidhje. Paralajmërimet nga qytetarët për protesta të fuqishme për shkak të mungesës së ujit nuk janë zgjidhje. Qindra ankesa që arrijnë nga qytetarët me të drejtë pyesin. Pse po diskriminohemi. Drenasi dhe qytetarët e komunës nuk meritojnë diskriminim. Fundja, diskriminimin nuk do ta lejojmë. Do t'i drejtohemi organeve të drejtësisë për mosangazhim të KRU "Prishtinës". Do të kërkojmë drejtësi për mosveprim në pajtim me mandatin dhe përgjegjësinë. Drenasi ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për shtetformim e shtetndërtim dhe nuk e meriton diskriminimin. Të nderuar të pranishëm, qeveria për më keq ka goditur edhe gjigandin e ekonomisë së Kosovës, burimin e të ardhurave të mijëra qytetarëve të Drenasit duke mos e furnizuar Feronikelin me rrymë, si burim të mirëqenies në komunën tonë. Ndërprerja e punës në Feronikel ka shkaktuar vështirësi ekonomike shtesë, duke ndikuar edhe në furnizimin me ujë që vinte nga mirëmbajtja e pompave të KRU "Prishtina" në Bivolak të Vushtrrisë. Pas mbylljes së Feronikelit kanë filluar edhe problemet me ujë. Komunikimi i KRU "Prishtina" me Komunën ka qenë shumë joparimor. KRU "Prishtina" asnjëherë nuk është kyçur në dëgjimet buxhetore, nuk ka marrë pjesë dhe nuk ka bërë kërkesa për Komunën, nuk është marrë me detyrat dhe përgjegjësitë e veta për mbylljen e gropave apo kanaleve, nuk e ka marrë përgjegjësinë për pronat e shpronësuara nga Komuna për interesin e KRU "Prishtinës". KRU "Prishtina" nuk i mori në menaxhim burimet e ujit, stacionin e pompimit në Drenas, Çikatovë, Poklek, rezervarët, të gjitha janë investime nga komuna për t'i shërbyer KRU "Prishtinës", për t'ia lehtësuar punën dhe obligimin për të furnizuar qytetarët e Drenasit. Para dy-tre ditëve kemi përuruar çerdhen në Arllat, e kemi përshëndetur këtë renovim të objektit nga Qeveria, por çështja është. A ka ujë në çerdhe. Ne i përshëndesim investimet në të gjitha komunat e Kosovës, por edhe Drenasi është komunë, bile në zemër të Kosovës. Ku janë miliardat e buxhetit të shtetit, buxhetit të qytetarëve që ngecin për investimet në disa dhjetëra mijëra euro për furnizimin me ujë të komunës së Drenasit.

Këto nuk janë qëndrime politike, sepse ne i gëzohemi çdo investimi, por çështja është pse Drenasi mbetet anash. Nuk dua ta përmend këtu as rrugën me katër korsi, as qendrën e biznesit "Drenasi 2", as QKMF-në, as urën e Shtrubullovës, por dua ta them qartë. Drenasi nuk po furnizohet me ujë të pijes, nuk ka ujë. Drenasi nuk e meriton këtë qasje, Drenasi nuk e meriton të ketë diskriminim për çështjen më elementare jetësore, ujin e pijes. Po bëhen disa vite që ne jetojmë çdo ditë me këtë mungesë, këtu rrisim fëmijët, nipat e mbesat, këtu e shohim tërë shekullin tonë jetësor, në komunën e përparuar dhe me kushte për jetë më të mire dhe krenarë I bëjmë ftesë KRU "Prishtinës", i bëjmë ftesë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Mos i diskriminoni qytetarët e Drenasit, komunës në zemrën e Kosovës, me kontribut të jashtëzakonshëm për shtetformim e shtetndërtim. Pres mirëkuptim dhe veprim të menjëhershëm që sfida e ujit të pijes për qytetarët e komunës së Drenasit të zgjidhet sa më parë. Qindra

mesazhet tuaja, qytetarë të Drenasit, i kemi marrë çdo herë seriozisht. Por protestat e paralajmëruara nga qytetarët nuk i shohim zgjidhje. Kjo seancë le të shërbejë si pikë e vlimit të pakënaqësisë e protestës tonë për mungesën e ujit të pijes. Këtu po paralajmërojmë veprimet ligjore me padi ndaj përgjegjësve për moskryerjen e detyrave dhe përgjegjësive të punës për furnizim me ujë për qytetarët e komunës së Drenasit. Ne nuk kemi heshtur në kohët më të liga për komunën dhe Kosovën tonë, nuk do të heshtim as tash, përballë kërkesave krejt legjitime, krejt të qarta të qytetarëve.

Duam ujë për qytetarët e Komunës së Drenasit.

Driton Ajazi tha se, thirrja e kësaj seance të jashtëzakonshme ka qenë një thirrje që është dashur të bëhej edhe më herët dhe presioni për mungesën e ujit të shtohet, sepse kjo gjendje i ka rënduar qytetarët e Komunës së Drenasit me muaj të tërë, pasi uji i pijes është e drejtë, jo privilegj. Mungesa e ujit të pijshëm në Drenas është bërë një problem i papranueshëm për qytetarët tanë. Familjet po përballen me vështirësi të përditshme, ndërsa përgjegjësia e KRU "Prishtina" nuk mund të fshihet pas arsyetimeve, heshtjës apo premtimeve të përsëritura. Papërgjegjësinë e tyre e tregon edhe mungesa në këtë seancë të jashtëzakonshme, ku ata ishin fluar që, përveç neve si përfaqësues të qytetarëve, në të njëjtën kohë t'u raportojnë edhe qytetarëve se çfarë është duke ndodhur me mungesën e ujit të pijes në Komunën e Drenasit dhe kur pritet të rregullohet, të japin sqarimin dhe arsyetimin para të gjithë qytetarëve të komunës së Drenasit. Mungesa e tyre tregon neglizhencë ndaj qytetarëve të Komunës së Drenasit.Drenasi nuk kërkon favore. Kërkon shërbimin për të cilin paguan dhe të drejtën themelore për ujë të pijshëm. Është koha që KRU "Prishtina" të marrë përgjegjësinë dhe të veprojë me urgjencë. Të sigurojë furnizim të rregullt dhe të qëndrueshëm me ujë për të gjitha familjet dhe lagjet e Drenasit.
Të hartojë dhe zbatojë një plan emergjent furnizimi dhe zgjidhje alternative aty ku mungesa vazhdon. Të investojë në rrjetin e ujësjellësit dhe në eliminimin e defekteve, në mënyrë që qytetarët të mos mbeten peng i të njëjtave problem. Të informojë qytetarët në mënyrë transparente për shkaqet e mungesës, kohën e ndërhyrjeve dhe afatet e rikthimit të furnizimit. Ajo çfarë shkruan në atë shkresë që na u përcjell tani para se me filluar seanca është një shkresë koti, një papërgjegjësi totale nga kompania që është përgjegjëse për furnizim me ujë. Të japë llogari për çdo ditë pa ujë dhe për masat konkrete që po ndërmerren për zgjidhjen e problemit. Nuk mjaftojnë më deklaratat. Nuk mjaftojnë më arsyetimet. Drenasi ka nevojë për ujë, jo për justifikime. Kërkojmë nga KRU "Prishtina" që ta trajtojë këtë çështje me seriozitetin që meriton dhe të ndërmarrë menjëherë veprimet e nevojshme për furnizimin e Komunës së Drenasit. Uji i pijshëm është e drejtë e qytetarëve. Sigurimi i tij është përgjegjësi e kompanisë. Heshtja dhe neglizhenca nuk janë zgjidhje.
Ne kërkojmë që kjo çështje të trajtohet me seriozitetin më të madh. Të gjithë kemi qenë dëshmitarë që qeveria me dhjetëra tenderë një burimorë ka negociuar miliona, ndërsa tani arsyetimet e kotë në bazë të kësaj shkrese thuhet se vetëm në javët e para të tetorit do të rregullohet pompa që është jashtë përdorimit. Ka muaj të tërë që ajo pompë është me defekt; a nuk kanë mundur me i përshpejtuar procedurat, kur dihet se uji është e drejtë elementare për të gjithë qytetarët. Ky është një diskriminim i qytetarëve nga qeverisja qendrore, sepse ata tani me në Drenas nuk arrijnë të marrin votën ashtu qysh synojnë, por ne bëjmë lutje kompanisë që t'i kalojë dallimet politike dhe të veprojë, sepse uji është i domosdoshëm që jeta të zhvillohet në mënyrë normale.

Xhavit Drenori, u shpreh ne jemi mbledhur për një çështje që nuk mund të trajtohet si një problem i zakonshëm administrativ apo teknik, pasi po flasim për ujin e pijshëm, për një nevojë themelore të çdo familjeje, për shëndetin dhe dinjitetin e qytetarëve tanë, si dhe për kushtet në të cilat fëmijët tanë qëndrojnë në shkolla, veçanërisht tani kur ka filluar viti i ri shkollor. Ai theksoi se shqetësimi është i madh, por indinjata është edhe më e madhe, duke shtuar se është e vështirë të kuptohet se si një problem konkret teknik me një pompë mund të mbetet i pazgjidhur për kaq gjatë.
Qytetarët e Drenasit nuk po kërkojnë lluks apo diçka të jashtëzakonshme, por po kërkojnë ujë nga institucioni përgjegjës për ofrimin e këtij shërbimi. Drenori iu drejtua drejtpërdrejt KRU "Prishtina"- duke kërkuar përgjigje konkrete dhe jo arsyetime administrative, premtime pa afat apo përgjigje të përgjithshme. Pse Drenasi nuk ka ujë, kur do ta ketë në mënyrë të qëndrueshme, çfarë ka ndodhur me pompën në Bivolak, pse nuk është riparuar deri më tani, cila është pengesa, kush është përgjegjës për ndërhyrjen dhe kur do të përfundojë. Ai theksoi se këto janë pyetje legjitime të qytetarëve ku përgjegjësia dhe llogaridhënia duhet të jenë konkrete.
Në vijim, ai propozoi që nga kjo sallë të mos dalin vetëm me diskutim, por me afate konkrete
Së pari: Brenda 24 orëve nga përfundimi i kësaj seance, KRU "Prishtina" t'i dorëzojë Komunës një përgjigje zyrtare me shkrim mbi gjendjen e pompës në Bivolak, shkakun e defektit, masat që do të ndërmerren dhe personin ose njësinë përgjegjëse për ndërhyrjen.
Së dyti: Brenda 48 orëve, KRU "Prishtina" të paraqesë një plan konkret për riparimin ose zëvendësimin dhe funksionalizimin e pompës, me afat të saktë dhe datë konkrete për përfundimin e punimeve, e jo sa më shpejt" apo "brenda një periudhe të shkurtër".
Së treti: Deri në zgjidhjen e problemit kryesor, brënda 24 orëve, të përcaktohet një plan emergjent për furnizimin me ujë të zonave më të prekura dhe me prioritet, të shkollave e institucioneve të tjera publike, sepse fëmijët nuk mund të presin procedura të pafundme.
Së katërti: Brenda shtatë ditëve, KRU "Prishtina", në bashkëpunim me Komunën, të paraqesë një plan për vlerësimin e të gjitha burimeve alternative të ujit në territorin e Drenasit (Krajkova, Gjurgjica, Arllati, Kishnareka, Baica, Sankovci dhe lokacione të tjera) me përgjigje të qarta nëse mund të funksionalizohen, sa kushtojnë, çfarë ndërhyrjeje kërkojnë, sa kohë nevojiten dhe kush është përgjegjës.
Së pesti: Brenda 15 ditëve, të paraqitet një raport i përbashkët mbi investimet që Komuna e Drenasit ka bërë në infrastrukturën e ujit dhe statusin e secilit prej tyre, në mënyrë që të dihet pse ajo infrastrukturë nuk po e prodhon shërbimin për të cilin është ndërtuar.
Së gjashti: Kërkoi që çdo 7 ditë, deri në stabilizimin e plotë të furnizimit, KRU "Prishtina" t'i raportojë Komunës dhe qytetarëve mbi progresin e punimeve dhe masat e ndërmarra, pasi transparenca duhet të jetë pjesë e zgjidhjes. Ai tha se nuk kërkon konflikt me KRU "Prishtina", por përgjegjësi të matshme, duke bërë thirrje që institucionet qendrore dhe KRU "Prishtina" të bëjnë pjesën e tyre, sepse qytetari nuk duhet të jetë peng i ndarjes së kompetencave dhe ka nevojë për një zgjidhje reale e jo për premtime të tjera.

Liman Krasniqi, tha se edhe pse me vonesë ne e morëm një përgjigje nga kompania e ujësjellësit. Me një lexim shumë të shpejtë e pashë që janë munduar me i arsyetuar do çështje edhe me e bartë një pjesë të përgjegjësisë të Komuna e Drenasit, që nuk është e arsyeshme.
Ne të gjithë e kemi të qartë që Drenasi nuk po furnizohet me ujë. Në përgjigjen e tyre thonë që deri në javën e parë të tetorit do të ketë rregullim të pompave në Bivolak, po nuk kanë dhënë një arsyetim se çka deri në javën e parë të tetorit për popullatën. E dyta, kompanisë duhet t'i bëhet e

qartë së rrjeti i sistemit të ujësjellësit prej Bivolakut e deri të rezervarët e Feronikelit është përgjegjësi e kompanisë së ujësjellësit, ndërsa sa i përket rrjetit shpërndarës dhe investimeve që i ka bërë Kuvendi Komunal i Drenasit, nuk është përgjegjësi e komunës. Çdo sistem i ujësjellësit që ndërtohet në Drenas e ka pasur në mbikëqyrje ose në menaxhim edhe një përfaqësues të kompanisë së ujësjellësit, kështu që në momentin që përfundon ai sistem i ujësjellësit edhe bëhet pranimi teknik, kompania e ujësjellësit është e obliguar ta marrë në mirëmbajtje.
Kompania e ujësjellësit e thekson se nuk është paguar rryma për disa hidrostacione, por nëse kompania e bën inkasimin e atij rrjeti që e shpërndajnë atë hidrostacione, ata janë të obligueshëm me i marrë shpenzimet e rrymës e jo Kuvendi Komunal. Ata thirren edhe të fshatrat Krajkovë, Gjurgjicë, Arllat, Kishnarekë, Baicë, Sankoc – fshatrat të cilat furnizohen me burime vetanake. Kompania e ujësjellësit nuk ka çka merret me ato, le të merret me furnizimin e vendbanimeve duke filluar prej Drenasit, të cilat janë të lidhura me sistemin të cilin e menaxhon kompania e ujësjellësit. Unë kam punuar në kanalin e Ibër-Lepencit e kam lejuar një sasi prej 1700 litrash në sekondë, që ka qenë e barabartë me furnizimin e KEK-ut dhe të gjitha vendbanimeve që kanë qenë të lidhura. Sot nuk ka punime duke u zhvilluar, pse mos me pas ujë të mjaftueshëm. Por që çështjet të trajtohen dhe të zgjidhen më konkretisht, unë kisha kërkuar më konkretisht drejtoritë përkatëse të bëjnë një analizë së bashku me kompaninë e ujësjellësit se sa është kapaciteti prodhues i ujit të filtrat në Feronikel edhe sa janë kërkesat e popullatës tonë, që ne të kemi një elaborat për mënyrën e shpërndarjes të atij kapaciteti të ujit që përpunohet, që me iu dhanë prioritet vendbanimeve të cilat nuk kanë burime nëntokësore. Tani e kemi problemin me objektet shkollore, shëndetësore, si është gjendja e tyre, a kanë disa prej atyre objekteve puse të hapura, a funksionojnë pompat e tyre, që në një mënyrë që Kuvendi Komunal me pas mundësi me bërë intervenim të përkohshëm, po obligimet e veta kompania e ujësjellësit t'i çojë deri në fund, ashtu siç pati kërkesa prej bashkëfolësve, të kemi një afat dhe çka deri në atë afat.
Ne nuk po kërkojmë nga kompania me investu, por me mirëmbajt rrjetin të cilin e kanë, sepse për këtë rrjet kanë investuar Komuna e Drenasit por edhe nga donatorët e tjerë. Për fund e kam edhe një kërkesë për Drejtorinë e Infrastrukturës që të formojë një komision, mundet me qenë edhe ndonjë anëtar i Kuvendit, së bashku me përfaqësuesit e kompanisë së ujësjellësit të ulemi dhe t'i definojmë të gjitha çështjet. Burimet cilat i kemi si në Sankoc e disa të tjerë nuk i mbulojnë kërkesat e popullatës me furnizim me ujë, sepse në Sankoc unë kam qenë njeri prej atyre që ka siguruar donacionin është kapacitet i vogël i ujit që mundet me furnizu vetëm pjesën e Sankocit edhe atë vetëm nëse mirëmbahet. Ne atëherë kemi tentuar që të gjitha burimet e grykës së Kishnarekës edhe grykës së Nekofcit, që e kanë një sasi më të madhe të ujit, që sillen në rezervar që janë të ndërtuar në Komoran, pastaj rezervari i Komoranit me komuniku me rezervarin e Feronikelit, dhe në rastet kur ka defekte në periudha të shkurtra, kompania e ujësjellësit atë burim ta furnizojë, sepse problemi më i madh që paraqitet është qendra e Drenasit se s'kanë mundësi furnizimi tjetër. Kështu që ne duhet të bëjmë ndarjen e konsumatorëve që furnizohen me burime që janë brënda territorit të Komunës së Drenasit edhe konsumatorëve të furnizohen prej rrjetit që e menagjon kompania e ujësjellësit, që është një farë mënyre rrjet publik që duhet kompania ta mirëmbajë gjithqysh.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, tha se i dëgjova me vëmendje të gjitha fjalimet e asamblistëve, e kemi marrë edhe letrën e kompanisë të cilën e kanë dërguar dhe nuk e kanë gjetur kohën me ardhur dikush këtu me bashkëbiseduar me neve, i kemi fluar me na bërë një raport operacional, me na tregu se për sa kohë dhe kur mund të rregullohen këto defekte,

sepse pompat kanë defekt. Pompat në Bivolak janë vendosur në vitet e 80-ta që e furnizojnë Drenasin, Fushë Kosovën, Obiliqin dhe Feronikelin. Kjo po i bie që Feronikeli i ka mirëmbajtur ato pompa, sepse në momentin që e ka ndërpre punën Feronikeli, nuk ka pasur kush me i mirëmbajtur dhe ne po kemi pasoja. Komuna nuk e ka asnjë obligim për investime në ujësjellës, sepse ujësjellësi është kompani qendrore e cila është e licencuar për ujë dhe e ka për obligim me e ndërtuar gjithë rrjetin. Përveç ujit, e kanë obligim me e mirëmbajtur edhe rrjetin e ujërave të zeza, të cilin e kemi ndërtuar ne. Prandaj ne publikisht po ju bëjmë apel me e bërë një plan operativ dhe me na tregu se kur ka me pas Drenasi ujë, sepse rrezikimi i shëndetit publik në komunën tonë është tepër i madh.

Xhavit Drenori tha se, ne duhet t'i bëjmë të qartë njëri-tjetrit edhe qytetarëve, sa më shumë që e politizojmë këtë çështje, aq më vështirë e kemi për të ardhur te zgjidhja. Unë ju lus që të përmbahemi, sepse situata është e rëndë, sidomos tani pas hapjes së shkollave. Prandaj unë mbes në kërkesën time që e bëra më parë, që ne t'i analizojmë ose t'i shqyrtojmë disa çështje dhe të kërkojmë saktësisht raport për secilën pikë nga ato që i thashë më lart. Unë mendoj se duhet të harmonizojmë një tekst dhe, si Kuvend Komunal, t'i dërgohet KRU "Prishtinës" që të japë raport me shkrim ajo do të na ndihmonte që t'i mbajmë përgjegjës dhe do t'i ndihmonte një padie eventuale nga komuna jonë, pasi i kemi shterur të gjitha mundësitë njerëzore.

Driton Ajazi tha se, nga janari i këtij viti fshati Sankoc është shkëputur, komplet fshati; projekti që e ceki z. Krasniqi është bashkëfinancuar mes qytetarëve edhe organizatës OXFAM, domethënë kompania e ujësjellësit nuk ka investuar asnjë cent në rrjetin e fshatit Sankoc. Kemi bërë kërkesë me bashkësinë e fshatrave që mirëmbajtja e rrjetit edhe e furnizimit të kalojë te KRU "Prishtina". Janë përfunduar të gjitha procedurat edhe ka kaluar në menaxhimin e KRU "Prishtin", por ne nuk kemi fajc si qytetarë që ata nuk arrijnë me mbikëqyrë, domethënë me mirëmbajtë arsyetimi i tyre është se ka humbje të ujit kinse po e keqpërdor dikush ujin, por është përgjegjësi e tyre me i identifikuar keqpërdorimet. Kemi shkuar bashkë me administratorin në zyrat në Drenas dhe arsyetimi për me iu rikthye uji i pijshëm ka qenë kështu, "Secila familje ta ndërtojë pusetën para dyerve të tij, ta vendosë një orë matëse, pastaj ne e bëjmë një komision vlerësues, vijmë dhe e shikojmë a është përfunduar, pastaj e rikthejmë ujin". Kjo gjë është absurde, sepse një kompani që nuk e ka investuar asnjë cent për rrjetin, me kërkuar tani prej nesh me bërë pusetë edhe orëmatësa, nuk e di për çka inkason kompania. Uroj, Xhavit, të mos ketë karakter politik, por ashtu po duket.

Muhamet Xhemajli theksoi se, të gjithë parafolësit i thanë të gjitha çka u deshtë me i thënë, ne nuk po e politizojmë këtë çështje, por të gjithë e dimë që komuna jonë para disa vjetëve ka pasur një numër më të madh të banorëve, por për shkak të neglizhencës një pjesë e popullatës është detyruar me u larguar, sepse element kryesor për jetë është uji. Ne nuk jemi me akuzuar askënd, por me kërkuar llogari nga ata që janë përgjegjës që këtë shoqëri të paktën ta furnizojnë me ujë të pijshëm, sepse të gjitha çerdhet [dhe] shkollat nuk munden me funksionu pa ujë.

Liman Krasniqi tha se, unë kisha propozuar që të merremi me gjëra konkrete, sepse i kemi pa ujë objektet publike, siç janë shkollat, Qendrat e Mjekësisë Familjare, çerdhet. Është mirë që çdo drejtor të na raportojë se si e kanë gjendjen në objektet shkollore, shëndetësore edhe për pjesën e përgjithshme të popullatës, dhe në ato objekte, p.sh. shkolla, ku ka mundësi të jenë puset aty, të

shikojmë çka mundemi me bërë ne si Kuvend Komunal që pompat ekzistuese t'i aftësojmë derisa kompania e ujësjellësit nuk ndërmerr masa për rregullimin e pompave.Ndërsa sa i përket përgjigjes së z. Ajazi, çështja e investimit të kompanisë së ujësjellësit në orëmatës ose (ujëmatës), ne duhet me i tregu popullatës tonë se kompania e ujësjellësit nuk është kompani investive, është publike për mirëmbajtje; investimet që i ka bërë Kuvendi Komunal i ka marrë në mirëmbajtje kompania e ujësjellësit, që është e obliguar.

Xhavit Drenori, tha që të mos politizojmë, sepse nuk na ndihmon. Një gjë është e qartë, që qytetarëve të Drenasit duhet me iu thënë se ne që jemi këtu në këtë sallë nuk mundemi asnjë veprim me bërë në këtë moment për me ia lëshuar ujin atyre pa e rregulluar KRU-ja atë pompë në Bivolak. Nëse nuk mundemi ne me e zgjidhur problemin vetë, ne jemi të obliguar me bashkëpunuar me ata që e kanë për detyrë për me i shtypur procesct përpara, ose shkojmë protestojmë, sepse protesta është mjet demokratik. Paraprakisht unë mbes te kërkesa ime: të formulojmë një shkresë-deklaratë bashkërisht grupet parlamentare, dhe atë shkresë ia dorëzojmë KRU-së dhe i kërkojmë afatet për secilin veprim dhe nëse pas asaj nuk ka veprime konkrete, ne mundemi edhe me e paditur. Nëse vetëm mbesin kështu, vetëm fjalimet tona kush po i bën më të bukura para qytetarëve, nuk e besoj që në këtë mënyrë ju sigurojmë qytetarëve ujë.

Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci tha se, po ndërlidhem me diskutimet që i ngritën parafolësit, burimet alternative janë të domosdoshme për ujësjellësin në Drenas, sepse nëse ka një defekt në një anë, vjen burimi alternativ në anën tjetër, jo që do t'i plotësojë të gjitha kërkesat, por të paktën ato minimale. Komuna e ka riblerë burimin alternativ në Krajkovë për kompaninë e ujësjellësit, të cilin burim donatorët e jashtëm e kanë riparuar pas luftës në vitin 2004-05, po ashtu edhe te Kroni i Mbretit, Gjërgjicë, dhe burimet tjera, të cilat po ministria e planifikimit hapësinor dhe ambientit nuk i ka aktivizuar, ky është problemi. Prandaj, ne kemi marrë masa në shkolla, z. Krasniqi, në çdo shkollë kemi hapur puse, por në komunën tonë janë disa zona që jetojnë mbi thëngjill, shkolla teknike edhe në gjimnaz nuk mund të përdoret për asgjë, përveç për gjelbërim.
